



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 1089/2 prot.

Gramsh, më 08/04/2022

Vendim

Nr. 38, dt. 31.03.2022

Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh.

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjenca civile “Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh”, bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, neni 73, të VKM nr.384, dt.12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituruar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM nr. 453, dt.03.07.2019, “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti”, si dhe të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2;

V e n d o s i:

- I. Të miratohen listat në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh si më poshtë:
- II. Familja e z.**Neti Xhevit Kryemadhi** me përberje familjare 4 vetë, disponon banesë në pronësi por është nën normat e strehimit sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit 22/2018 “Për strehimin social” dhe ka të ardhura neto si familje 51.720 lekë në muaj. Sipas normativave të strehimit i takojnë 60m², pra struktura e apartamentit është 2+1, kufiri maksimal i kredisë sipas përbërjes familjare 4 vetë, dhe nivelit të të ardhurave neto të jetë 3,010,000 lekë.
- III. Të miratohet Lidhja 3-Formati i listës emërore.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave civile.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë
Xhulia GJINI

Konc.Xh.Gjini
Konf.G.Lena
Dosja: _____
Afati: _____

Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Greta LENA

